

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Max Watersports sh.p.k

Ne Durres, sot me date 21 Shkurt 2025

Ortaku i vetem themelues:

Znj. Malvina Pertafi, e datelindjes 08.08.1988 ,lindur ne Peshkopi e banues ne Durres,shtetas Shqipetar, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer **I85808060R**,me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **Max Watersports sh.p.k**.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Max Watersports sh.p.k

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj Shoqeria **Max Watersports sh.p.k**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi Znj. Malvina Pertafi, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline në Lagjia 13, Rruga Shkambi i Kavajes, Prane pistes Bleart ,Zone Kadastrale 8518 .Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Sporte ujore.Lundrim me motor uji, Flyboards, Pedalone, Bicikleta uji me korent, Lundrim me varke.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke, i nenshkuar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise.Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim ne statut duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;



- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i tretit ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise caktohet **Znj.Malvina Pertafi**, lindur ne Peshkopi, banues ne Durres, shtetas Shqipetar, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer **I85808060R**, e cila emërohet për një afat 5 vjecar me të drejtë përtëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese te Ortakeve te shoqërisë .

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesojë shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;



- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shqiperine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqerine ne mardhieniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parefinanciar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12



Shperndarja ose prishja e shoqeris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperis.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Malvina Pertafi

